



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

VENDIM

Nr. 29, date 29.07.2020

MBI

**“MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE TË INSTITUCIONIT
DHE SHTIMIN E RREGJISTRIT TË PROKURIMEVE PËR VITIN KALENDARIK
2020, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Bordi i Administrimit i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Arsimit nr. 27, datë 29.12.2017 për “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 38, datë 28.07.2020 “Mbi Propozimin për miratimin e shpërndarjes së të ardhurave të institucionit dhe shtimit të rregjistrit të prokurimeve në Universitetin e Arteve, për vitin kalendarik 2020” si dhe pasi shqyrtoi Relacionin e Rektoratit, relatuar nga Administratorja e Universitetit të Arteve Znj. Alma Sinanaj dhe pasi e diskutoi, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e shpërndarjes së të ardhurave të institucionit, në Universitetin e Arteve, për vitin kalendarik 2020, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e shtimit të rregjistrit të prokurimeve, në Universitetin e Arteve, për vitin kalendarik 2020, sipas tabelës nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Besnik Bisha (Anëtar)

Prof. Arben Basha (Anëtar)

Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)

Vladimir Llakaj (Anëtar)

Risena Xhaja (Kryetar)

Aida Martiro (Anëtar)

Lorenc Vangjeli (Anëtar)

